REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**
**Nr.07/351-46262**
**Dt.24.05.2017**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Shkelzen (Hysen) Roka** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhesë, me etazhitet B+P+4+NK në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

# AKTVENDIM

**I. I LEJOHET: Shkelzen (Hysen) Roka nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhes,** Sipas Projektit Kryesor të prezantuar (me vërejtjet e poshtë shënuara), në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban të rrugës "Tirana" dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07/351-5081/18, të datës 16.05.2016, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 5081/18, ZK: Gjakovë-J-Qytet, në pronësi të lartë përmendurit, në rrugën "Tirana", e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objekit është B+P+4+NK, në sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit prej **S=5042.51 m²**

| | | |
|---|---|---|
| **Bodrumi:** | **(Sip.Bruto): ......................** | **S=679.11 m²** |
| **Përdhesa:** | **(Sip,Bruto): ......................** | **S=733.44 m²** |
| **Kati i parë:** | **(Sip,Bruto): ......................** | **S=817.07 m²** |
| **Kati i dytë:** | **(Sip,Bruto): ......................** | **S=849.30 m²** |
| **Kati i tretë:** | **(Sip,Bruto): ......................** | **S=650.27 m²** |
| **Kati i katër:** | **(Sip,Bruto): ......................** | **S=648.74 m²** |
| **Ndër kulmi:** | **(Sip,Bruto): ......................** | **S= 664.51 m²** |

**Vërejtje: Kjo Leje Ndërtimi ipet më vërejtje ashtu që:**

- **Nuk lejohet konzola në pjesën e përparme të objektit më shumë se 1.40 m'.**
- **Nuk lejohet ngritja e bërthamës së shkallëve dhe liftit në kulmin e rrafshtë.**

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim - objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë byroja projektuese "Alba – CONARK" - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspekcionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

# A r s y e t i m

**Shkelzen (Hysen) Roka nga Gjakova**, me banim në rrugën "Skenderbeu", pn, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351-46262, dt. 27.10.2016, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhesë, me etazhitet B+P+4+NK, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 5081/18, ZK:,Gjakovë –J- Qytet, në pronësi të lartë përmendurit, në rrugën "Tirana" siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:1 000 , të datës 08.04.2016, i punuar nga NSH"Geogauss"-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 31.01.2017, në pronësi të Shkelzen (Hysen) Roka, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndës 355/17 të datës 31.01.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Lejen Mjedisore Komunale, me nr.07-351/3184, dt.08.05.2017, të lëshuar nga DUMM.
5. Kushtet Ndërtimore për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit banimor shumë banesor në me afarizëm në përdhese, ngastrën kadastrale me nr. 5081/18 :ZK: Gjakovë-J-Qytet, me nr. 07/351-5081/18, të datës 16.05.2016.
6. Deklaratë Pëlqimi Noterial, me nr.LRP.NR.3758/2016, dt.18.05.2016.
7. Deklaratë Pëlqimi Noterial, me nr.LRP.NR.2441/2013, dt.29.06.2013.
8. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr. 08-320/01-6962, dt.30.03.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Gjakovës.
9. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit afaristo banesor, me Investitor Shkelzen Roka nga Gjakova, në ngastrën kadastrale me nr.5081/18, të hartuar nga "Geomerkur"Sh.p.k.Gjakovë.
10. Pëlqimin Sanitar, me nr 14/530/01-6931 të datës 24.04.2017, nga Inspektoriati Sanitar komunal-Drejtoria për Punë Inspektuese.
11. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.61/17, me datë 11.04.2017, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme e R.K.S.
12. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-C-222 të datës 05.02.2017.
13. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 14.06.2016.
14. Vërtetimin nga K.R.M."Çabrati", të datës 09.06.2016.
15. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë, të datës 10.06.2017.
16. Pëlqimin nga PTK-Sh.A.Gjakovë, të datës 09.06.2017.
17. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Raiffeisen Bank, filiala në Gjakovë, të datës 17.05.2017.
18. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga byroja projektuese "Alba – CONARK" - Gjakovë.

**Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 19.189.48 Euro.**

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspekcionit ,
- Arhivës.

**Zyrtar i lartë për çështje juridike**

**Zenel Shabani, jur.dipl.**

**U. D. Drejtori**

**Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.**

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

# KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë Jasht Qytet

Shk. zvog. 1: 1000

Poseduesi: Roka Shkelzen (Hysen)
nga Gjakova




Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale:

| Nr. Parcelës | Plani | Vendi i quajtur | Kultura | Klasa | Sipërfaqja | | | Vërejtjet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Ha | a | m | |
| 5081/18 | | | Arë | 4 | 0 | 12 | 45 | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | Gjithësejtë | | 0 | 12 | 45 | |

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 31.01. të vitit 2017

VËRTETON:

K.K. GJAKOVË

# PLAN SITUACIONI

Z. kad. Gj.j.Qytet
Parcela nr. 5080/18




P = 1 : 500

08. Prill 2016 ..
Takeometri preçize
Auto CAD 2004

Punoi :N.SH. "Geogauss" Gjakovë
DREJTORI
Xhelil Terlini gjeom.